

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT - DRAFT

KËSHILLI I INVESTIMEVE

MBLEDHJA VII

AKSESI NË FINANCË NË AGROBIZNES

Tiranë, 29 Shtator 2016, 16:00 – 18:00

Takimi u mbajt në Hotel Tirana International dhe u kryesua nga Znj. Milva Ekonomi, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), me pjesëmarrjen e veçantë të Z. Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Zev/Ministrit të Financave Z. Ervin Mete, si edhe shoqatave të biznesit dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në sektorin e bujqësisë.

I. Hapja e takimit

Kryetarja e Këshillit të Investimeve, Ministër Milva Ekonomi, hapi takimin duke falenderuar për pjesëmarrjen, prezantoi anëtarët e rinj nga komuniteti i biznesit për periudhën 2016-2017: TAP, EHW, Balfin Group, Shoqata e Prodhuesve, Biznes Albania dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë. Kryetarja falenderoi Ministrinë e Bujqësisë për bashkëpunimin e deritanishëm me Këshillin e Investimeve, duke ju referuar edhe Mbledhjes së fundit të Qershorit ku analiza ishte në fushën e informalitetit në Bujqësi. Ministria përmendi reformat e rëndësishme të ndërmarra nga Qeveria dhe angazhimin serioz të Kryeministrit për të mundësuar zgjidhjen e problematikave të sektorit.

Më pas Kryetarja i dha fjalën Ministrit Panariti i cili përmbledhi disa nga arritjet e deritanishme në sektorin e bujqësisë, përpjekjet e Qeverisë në forcimin e kapaciteteve që ndihmojnë në rritjen e vlerës së shtuar dhe krijimin e standardeve për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore, si mbështetja për krijimin e magazinave frigoriferike, pikave të grumbullimit, linjave të përpunimit, linjave të paketimit dhe kalibrimin. Me konkretisht, Ministri nënvizoi :

- Rritjen e interesit të investitorëve dhe hapësirave të bujqësisë shqiptare për eksport sidomos në fruta, perime, bimë aromatike/mjekësore dhe peshkim;
- Profilizimin e bujqësisë dhe zhvillimin e avantazheve konkurruese dhe krahasuese me rajonin që do të çojnë gradualisht dhe në zgjidhjen e problematikës së fragmentimit dhe konsolidimit të fermave, por edhe në investime produktive në ata sektore që kanë perspektive konkurruese;
- Qëndrimin e tij sipas të cilit asistencë teknike dhe këshillimi bujqësor në vijim duhet të bëhet nga vetë grumbulluesit të cilët në dallim nga Drejtoritë e Bujqësisë janë direkt në kontakt me fermerin si edhe futjen e modelit ekonomik të zhvillimit të bujqësisë me porosi (contract farming);
- Angazhimin për rritjen e limitit deri në 90,000 Lekë, për transaksionet cash për efekt të kompensimit të TVSH, që mund të kryhen midis fermerëve dhe pikave të grumbullimit, duke nënvizuar lehtësitë që kjo do të krijonte për aktorët e përfshirë.

II. Prezantimi i Gjetjeve (paraprake) të barrierave të mundshme për aksesin në financim të agrobiznesit

Znj. Diana Leka, Sekretariati, solli në vëmendje të anëtarëve metodologjinë e punës së Këshillit dhe Sekretariatit në përzgjedhjen e temës për diskutim dhe konkretisht u shpreh se në këtë mbledhje do të prezantoheshin gjetjet e një raporti ende të papublikuar, të përgatitur nga eksperte të kontraktuar nga BERZH si një nga nga komponentët e mbështetjes teknike të BERZH për Lehtësim të Agrobiznesit Shqiptar. Qëllimi i analizës është të identifikojë pengesat dhe boshllëqet në sektorin e bujqësisë në kuadrin e zinxhirit të vlerës të nënsektorë prioritarë që do çojnë në investime të qëndrueshme, rritje dhe konkurrueshmëri të produkteve shqiptare. Prezantimi në Këshillin e Investimeve synon të gjenerojë debate dhe mbledhë ide për orientimin e investimeve në agro-industri. Ndaj, kjo Mbledhje e KI-së është e veçantë nga mbledhjet e tjera sepse Këshilli nuk do të prodhojë rekomandime konkrete por me tepër sugjerime për një fokusim të metejshëm të punës të inicuar në kuadrin e rritjes së investimeve në sektorin e Bujqësisë.

- Z. Luciano Leonetti, Konsulenti i kontraktuar nga BERZH, në prezantimin e tij u fokusua kryesisht në kufizimet jo-financiare të investimeve në sektorin e agrobiznesit si ato institucionale dhe në nivelin e zinxhirit të vlerës. BERZH përzgjedhi disa sektorë tradicionale të mbuluar nga IPARD si përpunimi i mishit dhe qumështit, fruta-perime, vajit të ullit dhe bimëve medicinale. Sektori ka potenciale për investime në bujqësi, por :Çështja qëndron tek përcaktimi i ndërhyrjeve që janë të zbatueshme në afat të shkurtër e më tej, të cilat do të sillnin fitime dhe investime të qëndrueshme. Tregu i brendshëm është tashmë në fazë konsolidimi që do të thotë se fitimi i disa kompanive është tashmë i qëndrueshëm ose i rritur, ndërkohë që është ulur punësimi, duke treguar një rritje të profesionalizimit, produktivitetit dhe rritje të kapitalizimit.
- Një tjetër aspekt i rëndësishëm është konsolidimi i aktorëve kryesorë të ushqimit në vend, të cilët preferojnë të diferencohen (zgjerohen vertikalisht). Ndërkohë bizneset e nivelit të dytë të cilat fillimisht kanë qenë të forta në aspekt rajonal, janë duke investuar më shumë për të sfiduar aktorët kryesorë vendas, si p.sh. në sektorin e mishit.

Agroindustria në përgjithësi në vend është e dobët dhe mund të forcohet nëse mbështetet në materiale të para të importuara nga jashtë. Ka vështirësi për të arritur marrëveshje midis prodhuesve dhe përpunuesve, që lidhet edhe me mungesën e shoqatave të përpunuesve dhe prodhuesve për të krijuar marrëveshje kuadër midis operatorëve. Gjithashtu, ekziston nevoja për një sistem të informimit të tregut, pasi ende ka probleme me orientimin e tregut si p.sh. nuk ka një informacion të saktë se cili është potenciali, mundësitë, çmimet dhe konkurrentët. Shikohet nevoja për asistencë teknike më cilësore, të fokusuar dhe të pavarur. Në aspektin institucional kufizime janë konsideruar nëpaqëndrueshmërinë e kuadrit ligjor, politik dhe institucional, përputhjen e pjesshme midis tyre, si dhe vështirësitë për të bashkërenduar procesin afatgjatë të ngritjes institucionale me nevojat operative në afat të shkurtër dhe të mesëm.

III. Komentet kryesore të adresuara në diskutim janë përmbledhur më poshtë:

Znj. Milva Ekonomi, Kryetarja e Këshillit, falenderoi për prezantimin dhe komentoi mbi impaktin e ndryshimeve institucionale dhe ligjore në bujqësi që nëse do të kishin qenë më të shpeshta ndoshta mund të sillnin dhe më shumë përfitime për biznesin. Ndërkohë, në lidhje me

përputhshmërinë midis politikave dhe kuadrit ligjor dhe institucional, Qeveria ka marrë herë pas here komente nga Delegacioni Evropian për mënyrën si është bërë përjasja në këto bashkëveprime. Znj. Ekonomi, ia la radhën për diskutim anëtarëve të Këshillit duke kërkuar një reagim të parë nga përfaqësuesit e biznesit.

Z. Luan Leka, EHW, shprehu dakordësinë me analizën e prezantuar në lidhje me problemet e paraqitura, sikurse mbështeti edhe mendimin e Z. Panariti për zhvillimin e sektorit. Sektori ka rritje gjatë këtyre viteve, por përsëri mbetet i prapambetur me shumë mundësi për t'u ristrukturuar dhe për të ofruar më shumë. Ka nevojë për disa ndërhyrje shumë të forta strukturore dhe për një vullnet politik. Duke e nisur nga aspekti politik, në lidhje me fragmentizimin e tokës, ekzistojnë toka të pashfrytëzuara. Nëse do të vendosej një taksë mbi tokën, atëhere toka ose do të punohej ose do të jepej në përdorim ose do shitej, duke rritur efektivitetin dhe interesin për përdorimin e tokës. Në lidhje me industrinë e përpunimit të produkteve bujqësore apo blegtoriale, Z. Leka parashtroi dy kushte për rritjen e industrive dhe daljen si industri konkurruese në nivel rajonal apo përtej: i) lufta ndaj informalitetit (si masë politike); ii) rishikimi i ligjeve të cilat garantojnë sigurinë ushqimore, të cilat duhet të jenë të njëjta me ato të vendete të BE, duke mundësuar konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare.

Z. Arben Shkodra, Shogata e Prodhuesve, mbështeti komentet e Z. Leka dhe u shpreh se modeli aktual i tregut është konfuz, dhe për këtë arsye duhet përcaktuar qartë nëse modeli i tregut për tu qasur BE, do të jetë si social apo industrial? Politikat duhet të orientohen për të krijuar një lloj qasje industriale dhe jo sociale, për të incentivuar sa më shumë industrinë. Në lidhje me procesimin e produktit bujqësor, ai aktualisht del nga Shqipëria në një formë shumë të thjeshtë, pa asnjë lloj përpunimi, duke krijuar një lloj avantazhi për vendet të cilat i blejnë, si p.sh. Maqedonia, e cila merr produkte shqiptare, i përpunon dhe më pas i markon duke i shitur më shtrenjtë në tregjet evropiane. Çmimi i tokës ndërkohë është një pengesë për investime. Në lidhje me aksesin në financë, Z. Shkodra shprehet se Ministria e Bujqësisë duhet të informojë më shumë prodhuesit dhe kultivuesit shqiptarë për instrumentet financiare në dispozicion të investitorëve.

Z. Mark Cranford, Dhoma Amerikane, propozoi që AIDA të jetë një institucion për tërheqjen e investimeve në këtë sektor me potencial. Disa nga risqet që shohin bankat kanë të bëjnë me kushtet atmosferike ndërkohë që një nga fushat në të cilën qeveria mund të angazhohet është sigurimi i mikrobiznesit dhe IFC ka krijuar një grup, MicroEnsure i cili ofron siguracione për kompani të vogla, në mënyrë që të mbrohet sektori financiar.

Z. Genti Begiri, AIDA, vuri në dukje që kërkesat për investime në sektorin e bujqësisë pranë AIDA-s janë ndër më të lartat, sidomos nga investitorë italianë, por ka disa problematika të evidentuara edhe nga AIDA, siç janë ato të konsolidimit të sektorit dhe tokës, por edhe në lidhje me ndihmën administrative që mund të japë AIDA si një instrument promovues i Ministrisë së Ekonomisë. Për këtë, AIDA ka nevojë: së pari, për projekte fizibël për investitorët nga ministrinë e linjës, në këtë rast nga Ministria e Bujqësisë; së dyti, të ofrohen asete të pastra publike për t'iu vënë në dispozicion të të gjithë sipërmarrësve të interesuar.

Z. Matteo Colangeli, Drejtor i Zyrës së BERZH në Tiranë, u shpreh se BERZH po investon në sektorin e bujqësisë nëpërmjet një Instrumenti Financiar të madh që po zhvillohet me Qeverinë, në bashkëpunim me gjashtë institucione financiare në Shqipëri. Suksesi i kësaj iniciative do të varet kryesisht nga aftësia e sektorit/industrisë për të thithur këto fonde, për t'i shfrytëzuar sa më mirë në aspektin ekonomik, dhe më pas për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të shlyer detyrimin e tyre ndaj bankave. BERZH nuk ndan vetëm risqet dhe ofron financim për gjashtë

institucionet financiare pjesëmarrëse, por edhe asistencë teknike për industrinë e bujqësinë për të mbështetur zhvillimin e zinxhirit të vlerës që të mund të zhvillojnë projekte të besueshme për financim. Gjithashtu, BERZH është duke asistuar bankat pjesëmarrëse në këtë instrument në lidhje me zhvillimin e produkteve të posaçme për këtë industri, e cila historikisht ka vuajtur aksesin e limituar në kredi, dhe më pas t'ia shitur me sukses fermerëve dhe kompanive bujqësore në vend. Studimi i prezantuar në këtë takim dhe diskutimet e gjeneruara do të jenë të dobishme për BERZH në formimin e kënvështimit mbi fushat e tjera prioritare të asistencës teknike të mundshme, për të mbështetur lehtësimin e investimeve në arritjen e rezultateve konkrete në terren.

Z. Yngve Engstroem, Delegacioni i BE, përmendi disa mekanizma të mbështetjes financiare të ofruara nga BE si: programin IPA për bujqësinë me rreth 70 milionë EUR financime në vitet e ardhshme; *Credit Guarantee Facility*, përveç asaj ofruar nga BERZH, në bashkëpunim me KfW, ku shteti është pronar, dhe instrumente të tjera si 50Fs, të Fondit Evropian për Evropën Jug-lindore (*European Fund for South-Eastern Europe*) ideal për fermerët e vegjël dhe që *duhet të promovohet* më shumë tek përdoruesit e vertetë. Çfarëdo lloj financimi që mund të ofrohet nëpërmjet kredive apo granteve nuk do të kenë asnjë efekt, nëse klima në të cilin vihen në punë nuk është e dobishme për investime. Mbeten ende disa çështje të rëndësishme që duhet të trajtohen si p.sh. problematika e tokës. Çfarëdo lloj plan investimi në këtë sektor duhet të shoqërohet me zgjidhjen e regjistrimit të tokës dhe ri-taksimi. Gjithashtu BE ka ofruar mbështetje prej shumë vitesh gjithëpërfshirëse (me shumë nënsektorë) në lidhje me kapacitetet institucionale dhe strukturat për të ofruar më shumë stabilitet të sektorit. Megjithatë asistenca mund të funksionojë nëse shoqërohet me një plan aksion të qartë nga ana institucionale, kështu që mund të bëjmë punë monitoruese të përbashkët me donatorët për zbatimin e planit të veprimit në mënyrë që impakti i financimit të jetë sa më i madh në rritjen e sektorit.

Z. Edmond Panariti, MBZHRAU, në lidhje me konsolidimin e tokës nënvizoi, ndarja është bërë sipas ligjit 7501 dhe Qeveria do të përfundojë me vendosmëri këtë proces. Janë dy mekanizma që çojnë në konsolidimin e tokës. *Së pari*, tregu i tokës, kush ka çertifikata pronësie hyn në mekanizmin e shit-blerjes dhe në këtë mes arrihet një sipërfaqe që konsiderohet minimalisht optimale për të filluar një biznes bujqësor, minimalisht 20 ha për të justifikuar kostot e mekanizmit bujqësor, kontributeve, etj. Tregu i tokës do të duhet kohë të funksionojë dhe çmimet e tokës të kthehen në realitet dhe jo të mbivlerësuar si tani. *Mekanizmi i dytë* është konsolidimi virtual i tokës, d.m.th. sipërfaqje që krijohen nga bashkime virtuale të fermerëve nëpërmjet agreguesve, si modeli i Xarrës në jug ku është krijuar një model kooperative i suksesshëm për eksport. Sfidat e bujqësisë shqiptare dhe institucioneve përkatëse janë të lidhura shumë me standartet e cilësisë dhe gjurmueshmërisë për i bërë konkurruese në tregjet evropiane. Një model që duhet promovuar për investorët është agro-turizmi që mund të jetë më rentabël dhe konkurrues sesa bujqësia e ekonomisë së shkallës, ku mund të krijohen edhe markat shqiptare dhe origjinale që mund të zgjerohen më tej, si psh tek vaji i ullirit.

Znj. Milva Ekonomi, Kryetarja e Këshillit, shtoi që Ministria e Ekonomisë sapo ka përfunduar një përpjekje për të ndërtuar një bazë të dhënash ku të gjitha pronat shtetërore dhe private do të vendosen në një website të aksesueshëm nga të gjithë individët. Projektet e fermerëve të vegjël nuk janë të bëra gati për kredi dhe fizibël, ndaj kanë nevojë për ndihmën e drejtorive rajonale të zhvillimit bujqësor në rritjen e besueshmërisë së projekteve të sektorit. Gjithashtu, koncepti agro-turizëm i orientimit të investimeve i shtruar nga Ministri i Bujqësisë nuk është ndeshur shpesh në

komunikimet me biznesin, por është një fushë që mund të konsiderohet në të ardhmen. Në Ministrinë e Ekonomisë kërkesa për regjistrimi produkte GI ka qenë në rritje për 2015 – 2016.

Z. Ervin Mete, Zv/Ministër i Financave. Në 2015, Ministria e Financave prezantoi rreth 26 masa të targetuara specifiku drejt bujqësisë, për të incentivuar dhe mbështetur si nga KM ashtu edhe nga MF, duke ceduar në një farë mënyre nga disa prej rregullave strikte fiskale. Vullneti i qeverisë vazhdon të mbetet, por problematik mbetet *konceptimi i qartë nga sektori që të furnizojë pjesën fiskale me kërkesa të qënësishme të targetuara që kanë impakt në terren*. Rritja e rimbursimit të TVSH-së nga 6% në 20% ishte një hap i guximshëm dhe tepër i diskutuar, i cili ka pasur vështirësi në praktikë. Shifrat tregojnë rreth 800 milionë LEK të rimbursuar me këtë skemë. Ndodhemi në një situatë shumë më pozitive pasi më përpara skema e rimbursimit pothuajse nuk ekzistonte fare, ndërkohë edhe pajisja me NIPT ka ndihmuar në fiskalizimin dhe vendosjen e një rregulli në industri. Gjithashtu, Z. Mete u ndal dhe tek ndërhyrjet për rimbursimin e përsheptuar të TVSH-së për eksportuesit. Ministra e Financave ka bërë aplikimin për në BE, si menaxhuese e Fondit për Mbështetjen e Bujqësisë dhe si rrjedhojë mbështetja IPA pritet të fillojë vitin e ardhshëm me 70 milionë EUR.

Z. Shkëlqim Bozgo, TAP, informoi që Projekti TAP është në fazat e tij intensive, ndërkohë që një nga pritshmëritë më të mëdha në Shqipëri është angazhimi i bizneseve lokale. Një nga sfidat që biznesi shqiptar, (sidomos kompanitë e ndërtimit) është përballur ka qenë pranimi i standarteve të larta të TAP përsa i përket sigurisë në punë apo edhe standardeve të punimeve për t'u kryer. Kompanitë shqiptare kanë patur një ambicie të lartë për t'i arritur ato, të cilat edhe i kanë arritur, po të vërehen punimet e kryera. Po kompanitë shqiptare kanë bërë përmirësimin e kadastrës së tokës për projektin TAP dhe që mund të jetë një shembull shumë i mirë. Intensiteti i punës do të rritet shumë në dy vitet e ardhshme, dhe TAP mund të jetë një shkollë shumë e mirë për kompanitë shqiptare që do të kenë mundësinë të angazhohen në këtë projekt, dhe për shumë individë TAP organizon programe të ndryshme kualifikimi. Sfidat do të jetë kur të bie ritmi i ndërtimit, dhe kjo ndoshta mund të jetë objekt i një diskutimi të ardhshëm se “Cila do të jetë qëndrueshmëria e orientimit të këtyre bizneseve, të kapaciteteve të ngritura, fusha të tjera?”. Kompanitë shqiptare që do të kenë mundësinë të punojnë me TAP-in do të pajisen me një certifikatë në mënyrë që të shtrijnë aktivitetin e tyre edhe në tregjet ndërkombëtare.

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, theksoi se zgjidhja e problematikës së tokës në rastin e TAP mund të shërbejë si model për bujqësinë pavarësisht vështirësive që ka sektori dhe fragmentizimin e tij. Në lidhje me mungesën e aftësive të kualifikuara, Sekretariati ka mbledhur mjaft komente nga palë të interesuara, dhe kjo temë do të jetë një nga çështjet e ardhshme ku do të punohet, mundësisht me bashkëpunimin e të gjithë anëtarëve për të dhënë rekomandime sa më konkretet në të këtë aspekt. Gjithashtu, në referencë edhe me rekomandimet e mëparshme të Këshillit që AIDA të promovojë sektorin, fillimisht duhet të ketë produkte, dhe ndaj është e nevojshme që gjitha ministritë e linjës t'i komunikojnë AIDA-s pronat shtetërore të cilat mund të kthehen në investime *brownfield*. Pas muajit prill 2016, kur është bërë një rekomandim i tillë nga KI, një grup pune është ngritur nga Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me AIDA-n, dhe duke përfutur nga kjo mbledhje, Znj. Leka kërkoi njëkohësisht edhe ndihmën e Ministrisë së Bujqësisë, për ta konsoliduar grupin e punës dhe për të ardhur me një listë pronash publike të mundshme të cilat mund të jepen me qera për përdorim apo edhe ofrimin e produkteve të tjera që mund të promovohen nga AIDA. Në mbledhjen e ardhshme të KI, do të bëhet një analizë për rimbursimin e TVSH-së ku i kërkohet bashkëpunim të gjitha palëve për të nxjerrë rekomandime në shërbim të të gjithë aktorëve.

IV. Mbyllja e Mbledhjes- Mbledhja u konsiderua e mbyllur në orën 18:00.

Nr.	SUGJERIME	KOMENTE NGA ANËTARËT
1.	Zhvillimi i Agroturizmit, i lidhur me markat shqiptare dhe produktet origjinale autoktone – sugjerohet të jetë një nga drejtimet ku të fokusohen investimet në Bujqësi	
2.	Ka nevojë për ndërhyrje të forta strukturore me nje vizion të qartë politik, nëse jemi për një bujqësi sociale apo industriale. Të vazhdohet formalizimi i bujqësisë i mirëkoordinuar me rishikimin e ligjeve të sigurisë ushqimore. Të saktësohen sektorët që paraqesin avantazhe konkurruese dhe të targetohen investimet me qëllim që të largohemi nga heterogjeniteti, të replikohet modeli i “<i>contract farming</i>” për të profilizuar sektorin dhe penguar fragmentizimin e mëtejshëm.	
3.	Hartimi i një plani aksioni të qartë nga ana institucionale me detyra dhe afate të ndara në kuadrin e asistencës së BE – i cili t’i paraprijë ndryshimeve ligjore dhe institucionale që ndikojnë në suksesin e reformave.	
4.	Fragmentizimi i tokës mund të minimizohet nëpërmjet krijimit efektiv të tregut të tokës e cila kërkon kohë. Ndërkohë, derisa ky treg të stabilizohet, të nxitet roli i grumbulluesve bujqësorë që mundësojnë bashkimin virtual të tokës. MBZHRAU duhet të informojë fermerët dhe investitorët mbi instrumentat e financimit për biznesin në sektorin e bujqësisë.	
5.	MBZHRAU të konceptojë kërkesa të qenësishme e të targetuara për incentivat fiskale me impakt në praktikë. Ministria e Financave ka treguar nje reagim mjaft fleksibel për të mundësuar stimulimin e zhvillimit të sektorit me ndërhyrje në legjislacionin fiskal.	

6.	Suksesi i asistencës së ofruar nga Qeveria dhe EBRD, do të varet shumë nga aftësia për t'i thithur këto фонде, zbatuar projektet dhe vecanërisht ngritjes së kapaciteteve në drejtim të zinxhirit të vlerës në sektorët që do të konsiderohen si prioritare.	
7.	MZHEJTTS të përgatisë dhe të bëjë të aksesueshme për investitorët një inventar të pronave publike. Të përgatitet një listë e aseteve publike përfshirë edhe asetet në pronësinë e Ministrisë së Bujqësisë që mund të jepen me qera apo shiten (privatizohen) nga investitorët. Ky inventar të përdoret nga AIDA, investitorët dhe bashkitë si informacion për targetimin e investimeve.	

Lista e Pjesëmarrjes

Përfaqësues nga Qeveria

1. Znj. Milva Ekonomi, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë, në mungesë të Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë;
3. Znj. Blerina Gjoni, Këshilltare, në mungesë e Znj. Ermonela Felaj, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ;
4. Z. Genti Beqiri, Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s;
5. Z. Erion Prifti, Drejtor i Shërbimit të Tatimpaguesve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në mungesë të Znj. Vasilika Vjero, e sapoemëruar Drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve
6. Znj. Arjana Dyrmishi, Këshilltare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në mungesë të Z. Belinda Ekonomi, e sapoemëruar Drejtoreshë e Përgjithshme e Doganave.

Komuniteti i Biznesit

1. Z. Shkëlqim Bozgo, Menaxheri i TAP-it për Shqipërinë
2. Z. Luan Leka, CEO i EHË GmbH
3. Z. Edlira Muka, CEO i Balfin Group
4. Z. Arben Shkodra, Kryetar i Shoqatës së Prodhuesve
5. Z. Adamantios Frantzis, Drejtor i Përgjithshëm i TITAN ANTEA CEMENT

Partnerë Ndërkombëtarë

1. Z. Yngve Engstroem, Shef i Sektorit të Zhvillimit, Delegacioni i BE-së
2. Z. Matteo Colangeli, Shef i Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Silva Mauri, Specialiste e Bujqësisë në mungesë të Znj. Tahseen Sayed, Drejtoreshë e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri

Nuk morën pjesë:

1. Z. Bledi Çuçi, Ministër i Shtetit për Çështjet Vendore/Koordinator Kombëtar i Strategjisë kundër Korrupsionit
2. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Tiranë

I ftuar i veçantë

Z. Edmond Panariti, Ministër, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave